



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministrit-Kabinet Ministra-Cabinet of the Minister

REPUBLICA E KOSOVES, REPUBLICA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
Njësia Org. Organizacija Orgel	01
Mr.Prost. Broj.Prost. Prostovo	3399
Mr. i Regj. Broj. Regj. Regj.	1
Data. Datum Date	07.07.20

01.Ref. Nr.09
Prishtinë, 07.07.2020

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10, 11, dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), si dhe nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 13 të Rregullores Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, merr:

V E N D I M

1. Formohet Trupa Koordinuese për Inspektime për zbatimin e masave të Qeverisë së Kosovës të përcaktuara me vendimin nr.01/10, të datës 05.07.2020, për luftimin e COVID-19.
2. Trupa Koordinuese për Inspektime është në këtë përbërje:
 - 2.1. Inspektorati i Tregut - kryesues;
 - 2.2. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës - anëtar;
 - 2.3. Inspektorati i Punës - anëtar;
 - 2.4. Kolegjiumi i Inspektorateve në Nivel Komunal - anëtar.
3. Trupa Koordinuese për Inspektime koordinon aktivitetet dhe masat lidhur me zbatimin e masave të Qeverisë së Kosovës, rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për luftimin e COVID-19, deri në një vendim tjetër.
4. Trupa Koordinuese për Inspektime për punën e kryer i raporton Ministrit të MTI-së.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Veseli KRASNIQI

Ministër



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/MTI;
- Anëtareve të trupës koordinuese;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MTI-së.